

835 TË DHËNAT PËR PIKËQASJEN E FSHIRË

Fusha shpjegon se përse pikëqasja në fushën 2XX është fshirë nga baza e njësuar e të dhënave. Fusha 835 plotësohet në regjistrimet, në të cilat në nënfushën 001a – *Statusi i regjistrimit* ndodhet kodi "d" – *regjistrim i fshirë* ose "r" – *regjistrim i ndarë*.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
835	Të dhënat për pikëqasjen e fshirë	r
a	<i>Teksti i shënimit</i>	r
b	<i>Pikëqasja zëvendësuese</i>	r
d	<i>Data e veprimit</i>	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

835a Teksti i shënimit

Nënfusha përmban shpjegimin.

835b Pikëqasja zëvendësuese

Nënfusha përmban pikëqasjen, e cila ka zëvendësuar pikëqasjen e fshirë në fushën 2XX.

835d Data e veprimit

Data e veprimit shënohet në formën VVVVMMDD. Nëse përdorni fushën 835, plotësimi i kësaj nënfushe është i domosdoshëm.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

001a *ETIKETA E REGJISTRIMIT, Statusi i regjistrimit*

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

001	□□	ar
200	□1	a Bartol b Tomaž
835	□□	a Adashë b Bartol, Tomaž, 1962- b Bartol, Tomaž, 1968- d 20011212